

# MASTER

EKONOMIK • JURIDIK • SHKENCA SOCIALE



www.uet.edu.al

## QARTESOHU!

EKSPERIENCA TE DIFERENCON.



Universiteti  
European i  
Tiranës

[www.uet.edu.al](http://www.uet.edu.al)  
Cel: 068 20 16 616

banka dhe sigurime • marketing • menaxhim biznesi • juridik • marrëdhënie publike • gazetari • shkenca politike • diplomaci

### PROGRAMET MASTER – 12 muaj / 60 kredite

<b>1. Gazetari</b>	<b>2. Marrëdhënie Publike</b>	<b>3. Shkenca Politike</b>	<b>4. Marrëdhënie ndërkombëtare - Diplomaci</b>	<b>5. Studimet Europiane</b>
a. Gazetari televizive	a. Marrëdhënie publike për sektorin komercial	a. Sjelljet dhe strategjitë politike	a. Çështjet e ballkanit	a. Politikat në BE
b. Gazetari (çështje politike)	b. Marrëdhënie publike politike dhe institucionale	b. Politikat publike	b. Studimet amerikane	b. Ekonomia në BE
<b>6. Banka dhe Sigurime</b>	<b>7. Marketing</b>	<b>8. Menaxhim Biznesi</b>	<b>9. Juridik</b>	
a. Banka	a. Shërbime Turizmi	a. Menaxhim i SME-ve	a. E drejta administrative	
b. Sigurime	b. Inovacione dhe tregje strategjik	b. Menaxhim i burimeve njerëzore dhe karrierës	b. E drejta ndërkombëtare	
c. Politika Fiskale	c. Marketing Bankar dhe financiar	c. Institucione dhe administrim publik	c. E drejta europiane	

### PROGRAMET DND – 24 muaj / 120 kredite

<b>1. Komunikim Marrëdhënie Publike</b>	<b>2. Shkenca politike</b>	<b>3. Marrëdhënie ndërkombëtare</b>	<b>4. Financë-Bankë</b>	<b>5. Administrim Biznesi</b>
a. Studime dhe teoritë e komunikimit	a. Politikë e krahasuar	a. Organizata ndërkombëtare	a. Banka dhe tregje financiare	a. Biznes - Marketing
b. Marrëdhënie publike	b. Teoritë politike	b. Studime strategjike	b. Ekonomi - Financë	b. Administrim Publik
				c. Ekonomia Europiane
<b>6. E drejtë Private dhe Biznesi</b>	<b>7. E drejtë Publike dhe Ndërkombëtare</b>			
a. E drejta private	a. E drejta penale			
b. E drejta e biznesit	b. E drejta publike dhe kushtetuese			
	c. E drejtë ndërkombëtare dhe europiane			

Shënim: Me numër është shënuar emërtimi i programeve DND dhe Master, ndërsa me gërma profilet për secilin program.

## KRITERET E PRANIMIT TË STUDENTËVE

### PROGRAMET MASTER

---

#### a) Parimet e pranimit të studentëve.

Programet e ciklit të II-të Master të studimeve në UET synojnë që të angazhojnë studentët në sfidën e përbashkët të thellimit të dijeve. Për këtë ne kërkojmë studentë me aftësi akademike që dëshirojnë të angazhohen seriozisht në projekte studimi individuale apo grupi, për të arritur së bashku krijimin e një mjedisi intelektual ku mësohet, debatohet dhe lindin ide të reja zhvillimi.

Në vlerësimin e aplikimeve për këto programe synojmë që të krijojmë një komunitet me interesa dhe background të ndryshëm sepse besojmë se diversiteti e bën procesin e mësimin më të pasur dhe i ndihmon studentët që t'i formulojnë idetë e tyre më mirë në perspektivë. Kështu që ne inkurajojmë për të aplikuar edhe studentë që kanë kryer studime universitare të nivelit të parë edhe në fusha të tjera nga ato të propozuara për nivelin e dytë në UET.

#### b) Kriteret e Pranimit

Në mënyrë që të pranohen në një drejtim studimi të ciklit të II-të Master në UET kandidatët duhet të plotësojnë këto dokumente:

1. Formularin e pranimit ( ky dokument mund të jetë edhe online)
2. Kopjen e noterizuar të diplomave të nivelit të parë që studenti ka fituar.
3. CV e kandidatit ku të paraqiten të dhëna biografike dhe të eksperiencave profesionale.
4. Një Letër Interesi (afërsisht 300 fjalë) ku të paraqiten objektivat profesionale, interesat kërkimore dhe nxitjet për të kryer studimet e nivelit Master.
5. Një projekt- ide ku të paraqiten interesat e tij shkencore gjatë programit Master
6. Dy Letra Rekomandimi të cilat garantojnë kompetencën profesionale, përgatitjen akademike dhe mundësinë e kandidatit për të kryer studime të nivelit Master.
7. Paraqitja e një dokumenti që tregon aftësitë e kandidatit në njohjen e një gjuhe të huaj përbën një avantazh.

### PROGRAMET DND

---

#### a) Parimet e pranimit të studentëve

Programet e nivelit të 2-të të studimeve në UET synojnë që të angazhojnë studentët në sfidën e përbashkët të thellimit të dijeve. Për këtë ne kërkojmë studentë me aftësi akademike që dëshirojnë të angazhohen seriozisht në projekte studimi individuale apo grupi, për të arritur së bashku krijimin e një mjedisi intelektual ku mësohet debatohet dhe lindin ide të reja zhvillimi.

Në vlerësimin e aplikimeve për këto programe synojmë që të krijojmë një komunitet me interesa dhe background të ndryshëm sepse besojmë se diversiteti e bën procesin e mësimin më të pasur dhe i ndihmon studentët që t'i formulojnë idetë e tyre më mirë në perspektivë. Kështu që ne inkurajojmë për të aplikuar edhe studentë që kanë kryer studime universitare të nivelit të parë edhe në fusha të tjera nga ato të propozuara për nivelin e dytë në UET.

#### b) Kriteret e Pranimit

Në mënyrë që të pranohen në një drejtim studimi të nivelit të dytë në UET kandidatët duhet të plotësojnë këto dokumente:

1. Formularin e pranimit ( ky dokument mund të jetë edhe online)
2. Kopjen e noterizuar të diplomave të nivelit të parë që studenti ka fituar.
3. CV e kandidatit ku të paraqiten të dhëna biografike dhe të eksperiencave profesionale.
4. Një Letër Interesi (afërsisht 500 fjalë) ku të paraqiten objektivat profesionale, interesat kërkimore dhe nxitjet për të kryer studimet e nivelit të dytë DND.
5. Një projekt-ide ku të paraqiten interesat e tij shkencore gjatë programit DND
6. Dy Letra Rekomandimi të cilat garantojnë kompetencën profesionale, përgatitjen akademike dhe mundësinë e kandidatit për të kryer studime të nivelit DND.
7. Paraqitja e një dokumenti që tregon aftësitë e kandidatit në njohjen e një gjuhe të huaj përbën një avantazh.

#### c) Procedurat e pranimit

Të gjithë dokumentet e mësipërme duhet të paraqiten një muaj përpara datës së caktuar në zyrën përkatëse të programeve DND pranë UET-së. Pas një vlerësimi formal të listës së dokumenteve të nevojshme ato do t'i kalohen Departamentit përkatës të Programit DND, i cili kryen një vlerësim profesional kushteve të çdo kandidati me kriteret akademike e shkencore të programit. Departamenti shpall listën e kandidatëve fitues për programet DND dy javë përpara fillimit të kursit.

## PROGRAMET MASTER

### GAZETARI

---

Lënda: Objektivat formuese të programit, kompetencat profesionale që synohen të arrihen në përfundimin e tij dhe ndihmesën për qëllim punësimi.

#### I - OBJEKTIVAT

Ky master ka për objektiv të formojë gazetarë, të cilët kanë kryer një fakultet të parë dhe janë angazhuar ose duan të angazhohen në media si gazetarë, reporterë, redaktorë etj. Masteri ka karakter të fortë profesional për të krijuar në harkun e 12 muajve njohuritë bazë dhe të aplikuara të profesionit të gazetarit apo njeriut të medias.

#### II - KOMPETENCAT PROFESIONALE

Masteri i aftëson studentët lidhur me nocionet dhe bazë dhe të thelluara të profesionit të gazetarisë, për shkrimin dhe raportimin e lajmit, për elaborimin e zhanreve gazetareske si dhe në të njëjtën kohë i aftëson ata për t'u orientuar në debatin bashkëkohor të medias dhe debatin bashkëkohor publik. Programin synon fort që përmes lëndëve me karakter praktik dhe atelieve t'i ushtrojë studentët drejtpërdrejt në produktin gazetaresk.

**Profili: GAZETARI TELEVIZIVE:** Studentët që do të zgjedhin këtë profil do të përqendrohen në njohjen më të thelluar dhe në aplikimin e zhanreve televizive, si dhe në njohjen e dinamikave të reja në të cilat kalojnë mediat vizive në epokën tonë dhe implikimet që kjo ka në transformimin e gazetarisë televizive.

**Profili: GAZETARI PËR ÇËSHTJET POLITIKE:** Studentët që do të zgjedhin këtë profil do të kenë një kompetencë të shtuar në mbulimin e çështjeve politike. Po ashtu ato do të njohin në mënyrë të thelluar dhe aplikative në zhanret tipike të gazetarisë politike, si komentit, analiza, fitcheri politik, opinionit etj.

**III-PUNËSIMI:** Disa prej mundësive të punësimit për të diplomuarit në këtë master janë:

a - Gazetar në median e shkruar dhe televizive; b - Redaktor, kryeredaktor i mediave shqiptare; c - pjesëtar në ekipet televizive; d - reporter, e - këshilltar në organet administruese të medieve; f- skenarist emisionesh dhe dokumentarësh televizive etj.

## M 1 : GAZETARI

### A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM / 1 lëndë

Nr.	GAZETARI	C
1	Debate bashkëkohore	6

### B - DISIPLINA TË FORMIMIT KARAKTERIZUES TË PROGRAMIT / 4 lëndë

#### I - TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË / 2 lëndë

Nr.	GAZETARI	C
1	Atelier e shkrim raportim lajmit	6
2	Komunikimi masiv bashkëkohor	8

#### II - LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE / 2 lëndë

Nr.	GAZETARI TELEVIZIVE	GAZETARI (çështje politike)	
1	Atelier e gazetarisë televizive	Zhanret e gazetarisë politike (raportimi, analiza, komentet dhe opinioni)	6
2	Produksioni në media (print, audio, video, media, multimedia)	Media dhe politika	8

### C - DISIPLINA FORMUESE TË NGJASHME OSE INTEGRUESE / 1 lëndë

Nr.	GAZETARI	C
1	Sociologji e komunikimit dhe teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK)	8
2	Komunikimi viziv (TV, foto)	8
3	Sociologji politike	8
4	Integrimi dhe politika e zgjerimit të BE-së	8
5	Ideologjitë dhe lëvizjet e reja politike	8

### D - DISIPLINA FORMUESE TË ZGJEDHURA / KURSE TË LIRA / 1 lëndë

1	Teknikat e advokimit dhe lobimit	8
2	Menaxhim dhe vlerësim projektsh	8
3	Burimet njerëzore dhe zhvillimi i karrierës	8
4	Praktikum i marrëdhënieve publike	8
5	Gjeopolitika në shek. XXI	8

### E - VEPRIMTARI FORMUESE

1	Praktikë / internship	4
---	-----------------------	---

### F - PUNIMI I DIPLOMËS

1	Punimi i diplomës	10
---	-------------------	----

## PROGRAMET MASTER

---

### MARRËDHENIE PUBLIKE

Lënda: Objektivat formuese të programit, kompetencat profesionale që synohen të arrihen në përfundimin e tij dhe ndihmesën për qëllim punësimi.

#### I - OBJEKTIVAT

Ky master ka për objektiv të formojë specialistë në fushën e marrëdhënieve publike, të aftë për të ndërmjetësuar aksionin e aktorëve të ndryshëm shoqërorë, të biznesit, të politikës apo të sektorit të shoqërisë civile me publikun dhe median, në funksion të prezantimit apo reklamimit të produktit të tyre në tregun e mallrave, shërbimeve apo të hapësirës publike.

#### II - KOMPETENCAT PROFESIONALE

Master i aftëson studentët lidhur me nocionet dhe bazë dhe të thelluara të profesionit komunikimit dhe të marrëdhënieve publike. Studenti përmes programit kupton sistemet aktuale të komunikimit dhe të medias dhe aftësohet të përdorë me efikasitet teknikat e duhura për të ndërmjetësuar shërbimet dhe produktet me publikun dhe median. Studentët mund të realizojë në mënyrë të specializuar kontaktin produkt- treg apo publik.

**Profili: MP PËR SEKTORIN KOMERCIAL:** Studentët që do të zgjedhin këtë profil do të përqendrohen në njohjen më të thelluar dhe në aplikimin e strategjive dhe taktikave të marrëdhënieve publike për sektorin e biznesit të prodhimit dhe të shërbimeve. Ky profil specializon dhe i jep një kompetencë të shtuar, krahas aftësive të përgjithshme në marrëdhëniet publike, pikërisht produktit të biznesit.

**Profili: MP POLITIKE DHE INSTITUCIONALE.** Studentët që do të zgjedhin këtë profil do të përqendrohen në njohjen më të thelluar dhe në aplikimin e strategjive dhe taktikave të marrëdhënieve publike dhe politike, të partive politike, të institucioneve shtetërore, të organizatave jofitimprurëse, të institucioneve të sektorit të tretë, humanitar, etj. Ky profil specializon i jep një kompetencë të shtuar, krahas aftësive të përgjithshme në marrëdhëniet publike produktit jokomercial, përqendruar tek politika dhe institucionet.

**III-PUNËSIMI:** Disa prej mundësive të punësimit për të diplomuarit në këtë master janë: a - Drejtues i marrëdhënieve publike në administratën shtetërore; b - Drejtues i marrëdhënieve publike në ndërmarrjet publike; c - Zëdhënës në të gjithë kategoritë e mësipërme; d - Drejtues i marrëdhënieve publike në partitë politike; e - Drejtues i marrëdhënieve publike në organizatat ndërkombëtare që punojnë në Shqipëri; f - Këshilltar për marrëdhëniet publike; g - Drejtues i marrëdhënieve publike në ndërmarrjet e mëdha private; i - Ekspert i komunikimit dhe marrëdhënieve publike në agjencitë private që ofrojnë shërbime marketingu (agjenci reklamash, agjenci marketingu, etj); j - Pedagog; k - Angazhim publik dhe politik.

## M 1: MARRËDHËNIE PUBLIKE

### A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM / 1 lëndë

Nr.	MARRËDHËNIE PUBLIKE (MP)	C
1	Debate bashkëkohore	6

### B - DISIPLINA TË FORMIMIT KARAKTERIZUES TË PROGRAMIT / 4 lëndë

#### I - TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË / 2 lëndë

Nr.	MARRËDHËNIE PUBLIKE	C
1	Konceptim dhe menaxhim fushatash	8
2	Komunikimi masiv bashkëkohor	8

#### II - LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE / 2 lëndë

Nr.	MP PËR SEKTORIN KOMERCIAL	MP POLITIKE DHE INSTITUCIONALE	C
1	MP biznesi	MP të organizatave	8
2	Reklama dhe promovimi	MP politike	8

### C - DISIPLINA FORMUESE TË NGJASHME OSE INTEGRUESE / 1 lëndë

Nr.	MARRËDHËNIE PUBLIKE	C
1	Sociologji e komunikimit dhe TIK ( teknologjitë e informacionit dhe komunikimit)	8
2	Komunikimi viziv (TV, foto)	8
3	Praktikum i marrëdhënieve publike	8
4	Produksioni në media (print, audio, video, media, multimedia)	8
5	Media dhe politika	8

### D - DISIPLINA FORMUESE TË ZGJEDHURA / KURSE TË LIRA / 1 lëndë

1	Teknikat e advokimit dhe lobimit	8
2	Menaxhim dhe vlerësim projektsh	8
3	Burimet njerëzore dhe zhvillimi i karrierës	8
4	Integrimi dhe politika e zgjerimit të BE-së	8
5	Psikologji marketingu	8

### E - VEPRIMTARI FORMUESE

1	Praktikë / internship	4
---	-----------------------	---

### F - PUNIMI I DIPLOMËS

1	Punimi i diplomës	10
---	-------------------	----

## PROGRAMET MASTER

### SHKENCA POLITIKE

---

**Lënda:** Objektivat formuese të programit, kompetencat profesionale që synohen të arrihen në përfundimin e tij dhe ndihmesën për qëllim punësimi.

#### I - OBJEKTIVAT

Ky master ka për objektiv të formojë politologë, të cilët kanë kryer një fakultet të parë dhe janë angazhuar ose duan të angazhohen në fushën e politikës, administrimit të çështjeve publike apo në fushën e kërkimeve politike. Masteri ka karakter të fortë profesional për të krijuar në harkun e 12 muajve njohuri të bazë dhe të aplikuara të profesionit të politologut apo të kërkuesit politik.

#### II - KOMPETENCAT PROFESIONALE

Masteri i aftëson studentët lidhur me nocionet bazë dhe të thelluara të profesionit të politologut, për analizimin dhe interpretimin e çështjeve politike, për pjesëmarrjen në organizmin e fushatave elektorale apo për angazhimin në funksionimin e sektorit publik. Ky program synon që duke theksuar lëndët me karakter praktik të aftësojë studentët për t'u përfshirë në aktivitete konkrete të administrimit politik dhe publik.

**PROFILI: Sjellja dhe strategjitë politike:** Studentët që do të zgjedhin këtë profil do të përqendrohen në njohjen dhe vlerësimin e thelluar të sjelljes politike të elektoratit dhe do të aftësohen në organizmin dhe administrimin e fushatave konkrete politike, private apo administrative.

**PROFILI: Politika publike:** Studentët që do të zgjedhin këtë profil do të kenë një kompetencë të shtuar në mbulimin dhe menaxhimin e çështjeve publike. Më konkretisht ata do të jenë të aftë të vlerësojnë dhe ideojnë politikën publike dhe më pas t'i zbatojnë ato në praktikë. Në këtë mënyrë ata do të jenë të aftë të angazhohen me sukses në sektorin publik dhe në administratë.

**III-PUNËSIMI:** Disa prej mundësive të punësimit për të diplomuarit në këtë master janë:

a – Këshilltar apo specialist në administratën publike; b – këshilltar apo specialist pranë partive politike në organizim dhe menaxhim fushatash elektorale; c – Specialist në organizata jo-fitimprurëse apo në institucione kërkimore; d – Specialist pranë grupeve të ndryshme të interesit apo në shoqata që mbrojnë interesat e caktuara; e – analist apo gazetar për çështjet politike dhe publike në mediat e shkruara.

## M1: SHKENCA POLITIKE

### A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM / 1 lëndë

Nr.	SHKENCA POLITIKE	C
1	Debate bashkëkohore	6

### B - DISIPLINA TË FORMIMIT KARAKTERIZUES TË PROGRAMIT / 4 lëndë

#### I - TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË / 2 lëndë

Nr.	SHKENCA POLITIKE	C
1	Politika dhe sistemet e qeverisjes të krahasuara	8
2	Politika e vendeve në zhvillim	8

#### II - LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE / 2 lëndë

Nr.	SJELLJA DHE STRATEGJITË POLITIKE	POLITIKA PUBLIKE	C
1	Sociologji politike	Vlerësimi i politikave publike	8
2	Konceptim dhe menaxhim fushatash	Menaxhimi i sektorit publik dhe administrata	8

### C - DISIPLINA FORMUESE TË NGJASHME OSE INTEGRUESE / 1 lëndë

Nr.	SHKENCA POLITIKE	C
1	Ideologjitë dhe lëvizjet e reja politike	8
2	MP politike	8
3	Politika e jashtme e krahasuar	8
4	Qeverisja dhe demokracia lokale	8
5	Integrimi dhe politika e zgjerimit të BE-së	8

### D - DISIPLINA FORMUESE TË ZGJEDHURA / KURSE TË LIRA / 1 lëndë

1	Teknikat e advokimit dhe lobimit	8
2	Menaxhim dhe vlerësim projektsh	8
3	Burimet njerëzore dhe zhvillimi i karrierës	8
4	Praktikum i marrëdhënieve publike	8
5	Gjeopolitika në shek. XXI	8

### E - VEPRIMTARI FORMUESE

1	Praktikë / internship	4
---	-----------------------	---

### F - PUNIMI I DIPLOMËS

1	Punimi i diplomës	10
---	-------------------	----

## PROGRAMET MASTER

### MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE - DIPLOMACI

---

Lënda: OBJEKTIVAT FORMUES DHE KARAKTERISTIKAT E PROGRAMIT TE STUDIMIT

a) Përshkrim i shkurtër i objektivave formues të programit të studimit Master

Ky program synon formimin profesional të specialistëve në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të diplomacisë konvencionale dhe asaj publike. Kjo do të arrihet përmes studimit të teorive kryesore mbi marrëdhëniet ndërkombëtare dhe njohjes me zhvillimet më të rëndësishme politike, diplomatike dhe ekonomike në marrëdhëniet midis shteteve në plan global dhe rajonal si edhe në kuadër të organizatave ndërkombëtare e rajonale. Studentët do të specializohen në dy profile të veçantë, çdonjëri prej të cilëve është i fokusuar në një rajon gjeopolitik shumë të rëndësishëm për interesat kombëtare të vendit tonë: Ballkani, dhe Shtetet e Bashkuara. Profilet do të quhen përkatësisht: Çështjet e Ballkanit, dhe Studime amerikane. Ky i fundit bëhet pjesë e një programi universitar në Shqipëri për herë të parë.

b) Profili profesional dhe sektorët e punësimit respektiv

Në përfundim të programit, në varësi të profilit në të cilin ata janë specializuar ngushtësisht (Çështje të Ballkanit apo Studime amerikane), studentët do të jenë të kualifikuar të punësohen në shërbimin diplomatik të Republikës së Shqipërisë, në institucione apo organizata të ndryshme ndërkombëtare ose rajonale në Shqipëri apo jashtë saj, në qendra dhe institucione studimore, të cilat objekt të kërkimeve të tyre kanë marrëdhëniet ndërshtetërore të vendit tonë me vendet e Ballkanit, me Bashkimin European dhe Shtetet e Bashkuara, politikat e sigurisë në rajon, bashkëpunimin rajonal, dhe integrimin e Shqipërisë në NATO dhe në BE. Mundësi të tjera reale për punësimin e tyre ofrojnë ata sektorë të medias në Shqipëri që fokusohen në analizën e marrëdhënieve të vendit tonë me vendet fqinjë dhe SHBA-në si edhe sektorë të ndryshëm të administratës shtetërore, veprimtaria e të cilëve ka të bëjë specifikisht me—apo është e orientuar nga—marrëdhëniet politike, ekonomike-tregtare apo kulturore me këta rajone dhe vende.

## M 1: MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE - DIPLOMACI

### A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM / 1 lëndë

Nr.	MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE - DIPLOMACI	C
1	Debate bashkëkohore	6

### B - DISIPLINA TË FORMIMIT KARAKTERIZUES TË PROGRAMIT / 4 lëndë

#### I - TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË / 2 lëndë

Nr.	MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE - DIPLOMACI	C
1	Politika e jashtme e krahasuar	8
2	Diplomaci publike dhe ekonomike	8

#### II - LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE / 2 lëndë

Nr.	ÇËSHTJET E BALLKANIT	STUDIME AMERIKANE	C
1	Politikat e identitetit në Ballkan	Politika dhe shoqëria në SHBA	6
2	Gjeopolitika aktuale e Ballkanit	Analiza e politikës së jashtme të SHBA-së	8

### C - DISIPLINA FORMUESE TË NGJASHME OSE INTEGRUESE / 1 lëndë

Nr.	MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE - DIPLOMACI	C
1	Teknika të negociimit ndërkombëtar	8
2	Marrëdhëniet transatlantike	8
3	Organizatat globale dhe rajonale	8
4	Gjeopolitika në shek. XXI	8
5	Historia moderne dhe bashkëkohore e Ballkanit	8

### D - DISIPLINA FORMUESE TË ZGJEDHURA / KURSE TË LIRA / 1 lëndë

1	Integrimi dhe politika e zgjerimit të BE-së	8
2	Konflikti arabo-izraelit: Nacionalizmi, territori, feja	8
3	Burimet njerëzore dhe zhvillimi i karrierës	8
4	Praktikum i marrëdhënieve publike	8
5	Menaxhim dhe vlerësim projektësh	8

### E - VEPRIMTARI FORMUESE

1	Praktikë / internship	4
---	-----------------------	---

### F - PUNIMI I DIPLOMËS

1	Punimi i diplomës	10
---	-------------------	----

## PROGRAMET MASTER

---

### STUDIME EUROPIANE

Lënda: Objektivat formues dhe karakteristikat e programit të studimit.

c) Përshkrim i shkurtër i objektiveve formues të programit të studimit Master

Ky program synon formimin profesional të specialistëve në fushën e studimeve europiane dhe të krahasuara. Synimi i programit do të arrihet përmes studimit të teorive dhe proceseve kryesore të integritit europian në fushën politike, ekonomike, financiare, tregtare, kulturore dhe të legjislativës. Studentët do të specializohen duke u fokusuar në këtë rajon gjeopolitik shumë të rëndësishëm për interesat kombëtare të vendit tonë dhe të ardhmen euroatlantike të tij. Programi ofron mundësinë e profilizimit në dy drejtime: Politika në BE dhe Ekonomia në BE.

d) Profili profesional dhe sektorët e punësimit respektiv

Në përfundim të programit, studentët do të jenë të kualifikuar të punësohen në shërbimin diplomatik të Republikës së Shqipërisë, në institucione apo organizata të ndryshme ndërkombëtare ose rajonale në Shqipëri apo jashtë saj, në qendra dhe institucione studimore, të cilat objekt të kërkimeve të tyre kanë komunitetin europian, politikën e sigurisë në rajon dhe integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian. Mundësi të tjera reale për punësimin e tyre ofrojnë ata sektorë të medias në Shqipëri që fokusohen në analizën e marrëdhënieve të vendit tonë me vendet BE-së apo vende të veçantë të tij si edhe sektorë të ndryshëm të administratës shtetërore, veprimtaria e të cilëve ka të bëjë specifikisht me integrimin e vendit tonë në këtë organizatë.

## M1 STUDIME EUROPIANE

### A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM / 1 lëndë

Nr.	STUDIME EUROPIANE	C
1	Debate bashkëkohore	6

### B - DISIPLINA TË FORMIMIT KARAKTERIZUES TË PROGRAMIT / 4 lëndë

#### I - TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË / 2 lëndë

Nr.	STUDIME EUROPIANE	C
1	Integrimi dhe politika e zgjerimit të BE-së	8
2	Bazat, evolucioni i acquis communautaire	8

#### II - LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE / 2 lëndë

Nr.	POLITIKA NË BE	EKONOMIA NË BE	C
1	Europianizimi dhe përshtatja e të drejtave kombëtare	Tregu i punës dhe politikat sociale në BE	8
2	Politika agro-ushqimore dhe mjedisore e BE-së	Analizë e ekonomisë së sektorëve dhe konkurrenca në BE	8

### C - DISIPLINA FORMUESE TË NGJASHME OSE INTEGRUESE / 1 lëndë

Nr.	STUDIME EUROPIANE	C
1	Marrëdhëniet transatlantike	8
2	Europa monetare & fiskaliteti në BE	8
3	E drejta private europiane	8
4	Gjeopolitika në shek. XXI	8
5	Organizatat globale dhe rajonale	8

### D - DISIPLINA FORMUESE TË ZGJEDHURA / KURSE TË LIRA / 1 lëndë

1	Teknikat e advokimit dhe lobimit	8
2	Menaxhim dhe vlerësim projektsh	8
3	Burimet njerëzore dhe zhvillimi i karrierës	8
4	Praktikum i marrëdhënieve publike	8
5	Të drejtat e njeriut (jurisprudenca & debati bashkëkohor)	8

### E - VEPRIMTARI FORMUESE

1	Praktikë / internship	4
---	-----------------------	---

### F - PUNIMI I DIPLOMËS

1	Punimi i diplomës	10
---	-------------------	----

## PROGRAMET MASTER

---

### BANKA & SIGURIME

Lënda: Objektivat formuese të programit, kompetencat profesionale që synohen të arrihen në përfundim të tij dhe ndihmesën për qëllim punësimi.

#### Objektivat Formuese

Formimi i ekspertëve dhe specialistëve cilësorë si në aspektet teorike ashtu edhe në aftësitë praktike aplikative në fushën e bankave, sigurimeve dhe politikave e sistemeve fiskale. Pajisja e tyre me njohuritë themelore teorike, praktikat bashkëkohore ndërkombëtare dhe përvojën e eksperiencën shqiptare në fushën e ndërtimit, funksionimit dhe menaxhimit të bankave, bursave dhe tregjeve financiare, shoqërive të sigurimit, fondeve specifike të investimeve apo pensioneve, institucioneve e strukturave të specializuara në sferën e politikave fiskale, tatimore e doganore, etj.

#### Kompetencat Profesionale

Njohja dhe menaxhimi i suksesshëm i bankave, shoqërive të sigurimit dhe tregjeve financiare në tërësi apo sektorëve specifikë të tyre në veçanti. Kompetenca të orientuara dhe specializuara në sferën e instrumenteve dhe politikave monetare, kontabilitetit bankar, marketingut bankar dhe sigurimeve, analizës së riskut dhe investimeve, tregjet e kapitaleve dhe bursat, standardet ndërkombëtare financiare dhe bankare, analizë dhe menaxhim i buxhetit qendror dhe atyre lokale apo të organizatave e institucioneve të ndryshme, politikat dhe paketat fiskale, sistemin e taksave dhe tatimeve dhe menaxhimin e tij, funksionimin dhe specifikat e doganave, sistemet dhe funksionimi i auditit të brendshëm dhe të jashtëm, etj.

#### Punësimi

Punonjës e drejtues bankash, shoqëri sh sigurimi apo institucione financiare në sektorë : politika monetare, mbikëqyrje bankare, operacionet monetare, sistemi pagesave, financa dhe kontabiliteti, statistikat bankare, teknologjitë e informacionit, analist dhe oficer kredie, analizë risku e menaxhim portofoli, shërbime të ndryshme bankare për klientët, sistemi leasing, marketingu bankar dhe sigurimeve, drejtori apo struktura të specializuara në studimin e tregjeve financiare kombëtare e ndërkombëtare, drejtori financiare apo kontabiliteti në institucionet publike kombëtare e lokale, sistemi i tatimeve dhe taksave, doganave, organe shtypi e media të specializuara në sferën financiare, bankave, etj.

## M 1: BANKA DHE SIGURIME

### A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM / 1 lëndë

Nr.	BANKA DHE SIGURIME	C
1	Kontabiliteti nacional	6

### B - DISIPLINA TË FORMIMIT KARAKTERIZUES TË PROGRAMIT / 4 lëndë

#### I - TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË / 2 lëndë

Nr.	BANKA DHE SIGURIME	C
1	Investimet dhe menaxhimi i portofolit	8
2	Institucionet financiare dhe tregjet e kapitaleve	6

#### II - LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE / 2 lëndë

Nr.	BANKA	SIGURIME	POLITIKAT FISKALE	C
1	Bankat dhe menaxhimi bankar	Menaxhimi i Sigurimeve	Analizë Buxheti (nacional dhe lokal)	8
2	Strategji dhe politika financiare	Analizë financiare e avancuar	Politikat dhe sistemet fiskale e tatimore	8

### C - DISIPLINA FORMUESE TË NGJASHME OSE INTEGRUESE / 1 lëndë

Nr.	BANKA DHE SIGURIME	C
1	Marketingu bankar dhe i sigurimeve	8
2	Auditi financiar dhe bankar	6
3	Standardet ndërkombëtare financiare dhe bankare	8
4	E drejta bankare dhe e sigurimeve	8
5	Ekonometri	8

### D - DISIPLINA FORMUESE TË ZGJEDHURA / KURSE TË LIRA / 1 lëndë

1	Teknikat e advokimit dhe lobimit	8
2	Menaxhim dhe vlerësim projektsh	8
3	Burimet njerëzore dhe zhvillimi i karrierës	8
4	Praktikum i marrëdhënieve publike	8
5	Debate bashkëkohore	6

### E - VEPRIMTARI FORMUESE

1	Praktikë / internship	4
---	-----------------------	---

### F - PUNIMI I DIPLOMËS

1	Punimi i diplomës	10
---	-------------------	----

## PROGRAMET MASTER MARKETING

---

**Lënda:** Objektivat formuese të programit, kompetencat profesionale që synohen të arrihen në përfundim të tij dhe ndihmesën për qëllim punësimi.

### Objektivat Formuese

Formimi i ekspertëve dhe specialistëve cilësorë në aspektet teorike edhe veçanërisht në aftësitë praktike aplikative në fushën e tregjeve, standardeve, marketingut, reklamës dhe promocionit, çmimeve, etj. Pajisja e tyre me njohuritë themelore teorike, praktikat bashkëkohore ndërkombëtare dhe përvojën e eksperiencën shqiptare në fushën e ndërtimit, funksionimit dhe menaxhimit të strukturave të specializuara në fushën e marketingut, promocionit dhe reklamave në sektorë të ndryshëm të biznesit dhe ekonomisë në përgjithësi, analizës dhe funksionimit të tregjeve specifike, psikologjinë e marketingut dhe negociatat në marketing, etj.

### Kompetencat Profesionale

Kompetenca në menaxhimi e sektorëve të marketingut dhe shitjeve në biznese të ndryshme prodhuese apo shërbimesh, financiare e bankare, turizmit, transportit, kozmetikës, sektorit agro-ushqimor, veshjeve, artikujve industrialë, sektorit të automobilave, elektro-shtëpiakeve, etj. Kompetenca të orientuara dhe specializuara në sferën e marketingut të turizmit dhe shërbimeve; tregjeve strategjike dhe inovacioneve; si dhe marketingut bankar, sigurimeve dhe financiar në përgjithësi.

### Punësimi

Ekspertë e drejtues të zyrave të marketingut, shitjeve dhe marrëdhënieve me klientët në biznese të llojeve të ndryshme; ekspertë e drejtues të agjencive turistike, të reklamave e atyre publicitare, shërbimeve të ndryshme, etj; ekspertë dhe drejtues të bizneseve të specializuara në aktivitete import-eksporti; ekspertë dhe drejtues në sektorin financiar, bankat dhe sigurimet në sferën e marketingut financiar dhe shërbimeve për klientët; ekspertë të media marketingut, medias në përgjithësi, etj.

## M 1: MARKETING

### A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM / 1 lëndë

Nr.	MARKETING	C
1	Marketing	8

### B - DISIPLINA TË FORMIMIT KARAKTERIZUES TË PROGRAMIT / 4 lëndë

#### I - TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË / 2 lëndë

Nr.	MARKETING	C
1	Teori dhe strategji marketingu të avancuara	6
2	Marketing strategjik	8

#### II - LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE / 2 lëndë

Nr.	SHËRBIME & TURIZËM	INOACION & TREGJE STRATEGJIKE	MARKETING BANKAR DHE FINANCIAR	C
1	Marketingu i shërbimeve dhe turizmit	Ekonomia dhe menaxhimi Inovacioneve	Strategji dhe politika financiare	8
2	Tregje dhe strategji turizmi	Konkurrenca dhe tregjet strategjike	Marketingu bankar dhe i sigurimeve	8

### C - DISIPLINA FORMUESE TË NGJASHME OSE INTEGRUESE / 1 lëndë

Nr.	MARKETING	C
1	Marketingu ndërkombëtar	6
2	Strategjitë e E-marketingut	6
3	Psikologji marketingu	8
4	Reklama dhe promovimi	8
5	MP biznesi	8

### D - DISIPLINA FORMUESE TË ZGJEDHURA / KURSE TË LIRA / 1 lëndë

1	Teknikat e advokimit dhe lobimit	8
2	Menaxhim dhe vlerësim projektsh	8
3	Burimet njerëzore dhe zhvillimi i karrierës	8
4	Praktikum i marrëdhënieve publike	8
5	Debate bashkëkohore	6

### E - VEPRIMTARI FORMUESE

1	Praktikë / internship	4
---	-----------------------	---

### F - PUNIMI I DIPLOMËS

1	Punimi i diplomës	10
---	-------------------	----

## **PROGRAMET MASTER**

---

### **MENAXHIM BIZNESI**

**Lënda:** Objektivat formuese të programit, kompetencat profesionale që synohen të arrihen në përfundim të tij dhe ndihmesën për qëllim punësimi.

#### **Objektivat Formuese**

Formimi i ekspertëve dhe specialistëve cilësorë me njohuri të plota në aspektet teorike edhe veçanërisht në aftësitë praktike aplikative në fushën e menaxhimit të bizneseve të vogla, të mesme e të mëdha; njësive të ndryshme të shërbimit si agjenci turizmi e transporti, institucioneve arsimore e shëndetësore, të medias së shkruar e asaj televizive; menaxhimit dhe analizës së politikave publike të institucioneve publike qendrore e lokale, OJF-ve, etj. Një objektivi i veçantë i është dhe kompletimi i njohurive në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore, karrierës, legjislacionit të punës dhe sjelljes organizative.

#### **Kompetencat Profesionale**

Kompetenca në menaxhimin e sektorëve të marketingut dhe shitjeve në biznese të ndryshme prodhuese apo shërbimesh, financiare e bankare, turizmit, transportit, kozmetikës, sektorit agro-ushqimor, veshjeve, artikujve industrialë, sektorit të automobilitave, elektro-shtëpiakeve, etj. Kompetenca të orientuara dhe specializuara në sferën e marketingut të turizmit dhe shërbimeve; tregjeve strategjike dhe inovacioneve; si dhe marketingut bankar, sigurimeve dhe financiar në përgjithësi.

#### **Punësimi**

Eksptërë e drejtues në sektorin e menaxhimit në biznese të llojeve të ndryshme prodhuese, shërbimesh e tregtare; menaxherë të kualifikuar të agjencive turistike e transportit, të reklamave e atyre publicitare, të institucioneve e strukturave të sistemit edukativ e arsimor, shëndetësor, mjedisor, etj; menaxherë dhe drejtues të bizneseve të specializuara në aktivitete import-eksporti, menaxherë dhe drejtues në sektorin financiar, bankat dhe sigurimet në sferën e marketingut financiar dhe shërbimeve për klientët; menaxherë të media marketingut, medias së shkruar dhe asaj televizive në përgjithësi, etj.

## M 1: MENAXHIM BIZNESI

### A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM / 1 lëndë

Nr.	MENAXHIM BIZNESI	C
1	Teori dhe strategji menaxhimi	6

### B - DISIPLINA TË FORMIMIT KARAKTERIZUES TË PROGRAMIT / 4 lëndë

#### I - TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË / 2 lëndë

Nr.	MENAXHIM BIZNESI	C
1	Menaxhimi operacional	6
2	Menaxhimi strategjik	8

#### II - LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE / 2 lëndë

Nr.	MENAXHIM I SME-ve	MENAXHIMI I BNJ & KARRIERES	INSTITUCIONE & ADMINISTRIM PUBLIK	C
1	Sipërmarrja dhe menaxhimi i SME-ve	Burimet njerëzore dhe zhvillimi i karrierës	Menaxhimi i sektorit publik dhe administrata	8
2	Konkurrenca dhe tregjet strategjike	Sociologji e organizatave, profesioneve dhe punës	Vlerësimi i Politikave Publike (8)	6

### C - DISIPLINA FORMUESE TË NGJASHME OSE INTEGRUESE / 1 lëndë

Nr.	MENAXHIM BIZNESI	C
1	Reklama dhe promovimi	8
2	Studime të avancuara në të drejtën e punës (sindikatat, mosdiskriminimi)	8
3	Ekonomia dhe menaxhimi inovacioneve	8
4	MP biznesi	8
5	Qeverisja dhe demokracia lokale	8

### D - DISIPLINA FORMUESE TË ZGJEDHURA / KURSE TË LIRA / 1 lëndë

1	Teknikat e advokimit dhe lobimit	8
2	Menaxhim dhe vlerësim projektsh	8
3	Praktikum i marrëdhënieve publike	8
4	E drejta e biznesit, norma dhe praktika	8
5	Debate bashkëkohore	6

### E - VEPRIMTARI FORMUESE

1	Praktikë / internship	4
---	-----------------------	---

### F - PUNIMI I DIPLOMËS

1	Punimi i diplomës	10
---	-------------------	----

## PROGRAMET MASTER

---

### JURIDIK

**Lënda:** Objektivat formuese të programit, kompetencat profesionale që synohen të arrihen në përfundim të tij dhe ndihmesën për qëllim punësimi.

#### a) Përshtrim i shkurtër i objektivave formues të programit

Ky master synon t'i aftësojë studentët me nocionet dhe shprehjet bazë teorike e praktike të profesionit të juristit të përgjithshëm, për të qenë të aftë të përballojnë detyra të zakonshme në administratën e gjykatave, prokurorive dhe institucioneve të tjera.

Programi do të realizohet nëpërmjet kurseve të posaçme të disa lëndëve që synojnë t'i formojnë më tej studentët, nëpërmjet zgjerimit, thellimit apo edhe plotësimit të njohurive që ata kanë marrë në DNP.

#### b) Profili profesional dhe sektorët e punësimit

Masteri në fakultetin juridik ka për objektivi të formojë juristë, mbi bazën e një formimi të mëparshëm si jurist në një fakultet juridik brenda apo jashtë vendit. Fjala është për ata që dëshirojnë të ingranohen shpejtë në tregun e punës, me një formim të posaçëm profesional të mëtejshëm. Ata mund të angazhohen në profile të ndryshme, zakonisht të karakterit administrativ në gjykata, prokurori, dhomën e avokatëve apo të noterëve si dhe në institucione të tjera qendrore e lokale, në sektorin publik ose privat.

Një drejtim tjetër i angazhimit të tyre do të ishte përfshirja në sektorë të ndryshëm, ku kërkohen njohuri të posaçme për të drejtën ndërkombëtare dhe atë europiane. Veçanërisht në kushtet aktuale, të avancimit të proceseve integruese në BE dhe në struktura të tjera ndërkombëtare e rajonale, mendohet se administrata shqiptare ka nevojë për një kategori të caktuar punonjësish të pajisur me dije speciale në këto fusha.

Ky master ka karakter të qartë profesional dhe do të formojë brenda një periudhe 12 mujore juristë me njohuritë bazë dhe të aplikuara të këtij profesioni.

**Profili: E drejtë administrative:** Ata që do të zgjedhin këtë profil do të përqendrohen në njohjen më të thelluar dhe në plotësimin e formimit të tyre me disiplina tradicionale dhe të reja të së drejtës administrative, të drejtës kushtetuese dhe të drejtës europiane e komunitare.

**Profili: E drejtë ndërkombëtare:** Ata që do të zgjedhin këtë profil do të kenë një kompetencë të shtuar në mbulimin e çështjeve të së drejtës ndërkombëtare. Ata do të përgatiten gjithashtu për të përballuar angazhime profesionale jo vetëm në organe që mbulojnë fushën e marrëdhënieve me jashtë në administratën vendase, por edhe në struktura të ndryshme të organizatave ndërkombëtare apo të përfaqësive të tyre në vendin tonë.

**Profili: E drejtë europiane:** Ata që do të zgjedhin këtë profil do të kenë një kompetencë të shtuar në mbulimin e çështjeve të së drejtës europiane e komunitare. Synohet që ata të aftësohen për të përballuar angazhime profesionale jo vetëm në organe që mbulojnë fushën e marrëdhënieve dhe të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë europian, duke u punësuar në organe që mbulojnë fushën e marrëdhënieve me jashtë në administratën vendase ose në struktura të ndryshme të organizatave europiane apo të përfaqësive të tyre në vendin tonë.

## M 1 : JURIDIK

### A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM / 1 lëndë

Nr.	JURIDIK	C
1	Debate bashkëkorore	6

### B - DISIPLINA TË FORMIMIT KARAKTERIZUES TË PROGRAMIT / 4 lëndë

#### I - TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË / 2 lëndë

Nr.	JURIDIK	C
1	Bazat, evolucioni i acquis communautaire	8
2	E drejta kushtetuese e krahasuar	8

#### II - LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE / 2 lëndë

Nr.	E DREJTË ADMINISTRATIVE	E DREJTË NDËRKOMBËTARE	E DREJTË EUROPIANE	C
1	Procedurë administrative	E drejta e detit dhe e hapësirës	E drejta private europiane	8
2	Studime të avancuara në të drejtën administrative	Gjykatat ndërkombëtare	Europianizimi dhe përshtatja e të drejtave kombëtare	8

### C - DISIPLINA FORMUESE TË NGJASHME OSE INTEGRUESE / 1 lëndë

Nr.	JURIDIK	C
